



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

Seria e Analizave Politike

Analiza Politike Nr. 16

# **Decentralizimi në Kosovë II: Sfidat e komunave me shumicë serbe**

Prishtinë, dhjetor 2009

[www.kipred.net](http://www.kipred.net)

Ky projekt është përkrahur nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, Kosovë.

Përgatitur nga: Ilir Deda dhe Krenar Gashi

Copyright © 2009 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Luteni të kontaktoni: [info@kipred.net](mailto:info@kipred.net) apo +381 38 227 778.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

Rexhep Mala, 5A, Kati II

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefon dhe Fax: +381 38 227 778

[www.kipred.net](http://www.kipred.net)

## I. Hyrje

Pas zgjedhjeve lokale të suksesshme të 15 nëntorit 2009, dinamika e decentralizimit dhe funksionalizimi i komunave të reja me shumicë serbe do të rriten. Graçanica, Klllokoti/Vërbovci dhe Ranillugu janë tri komunat e reja të krijuara dhe të legjitimizuara. Këto komuna kanë udhëheqësinë e tyre të ligjshme dhe të legjitimizuara, e cila është barabartë apo i tejkalon atë të strukturave paralele. Po kështu, për herë të parë në dy dekada, çështjet dhe problemet ndëretnike mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës po kalojnë në një platformë të mirëfilltët të divergjencave institucionale.

Megjithëkëtë, ky proces nuk do të kalojë pa sfida. Udhëheqësitë e reja komunale të serbëve të Kosovës ballafaqohen me presione nga komuniteti i tyre për realizimin e shpejtë të premtimeve që ata i kanë bërë, duke synuar drejt përmirësimit të shpejtë të jetës së tyre. Kryetarët e ri të komunave e kuptojnë këtë, dhe do të kenë tendenca të bëjnë presion për themelimin e shpejtë të komunave dhe zbatimin e projekteve zhvillimore dhe infrastrukturore komunale.

Qeveria e Kosovës, nga ana tjetër, po punon nën supozimin se do të kalojnë vite para se komunat e reja të bëhen plotësisht funksionale. Nëse Qeveria e Kosovës nuk jep përkrahjen e plotë për komunat e reja, kjo do të rrezikon vetëbesimin e serbëve dhe përshtatjen e tyre me kornizën ligjore dhe institucionale të Kosovës.

Ekzistimi i strukturave paralele paraqet një faktor tjetër pengues për funksionalitetin e komunave të reja. Përderisa strukturat paralele u ofrojnë serbëve vetëm përfitime financiare, ato nuk mund të ofrojnë zhvillim. Pagat e larta në komunat paralele nuk mund të krahasohen me ato të Kosovës. Megjithatë, roli i këtyre strukturave do të zvogëlohet nëse komunat e reja do të fillojnë të ofrojnë përmirësimin të prekshëm të cilësisë së jetës për serbët vendorë.

Një ditë pas parashtrimit të kërkesës për anëtarësim në BE në Stokholm, Serbia zotoi 42 milionë euro për strukturat paralele dhe nuk po tregon asnjë shenjë se do të ndryshojë politikën e saj drejt pjesëmarrjes së komunitetit serb në institucionet politike të Kosovës. Për më tepër, rruga e Serbisë drejt BE-së është plotësisht e hapur, pa ndonjë kushtëzim specifik për ndryshimi e politikës së saj drejt veriut të Kosovës. Përkundër bindjes së gjerë se komunat e veriut nuk bashkëpunojnë me Prishtinën, ato marrin ndihma të rregullta financiare nga Qeveria e Kosovës.

Në këtë dokument, KIPRED-i do të shqyrtojë sfidat kryesore në të gjitha komunat serbe në Kosovë, do të analizojë gjendjen dhe do t'ua jep rekomandimet për veprimet dhe politikat që duhet të ndryshohen autoriteteve relevante në mënyrë që procesi i decentralizimit të jetë i suksesshëm.

## II. Komunat e reja - Graçanicë, Kllokot/Vërbovc dhe Ranillug

Këto tri komuna pritet që shumë shpejt të kenë qeveritë e tyre komunale, por do të merr më shumë kohë para se këto qeveri të jenë plotësisht funksbimeve komunale për qytetarët e tyre.

Suksesi i decentralizimit në Graçanicë, Kllokot/Vërbovc dhe në Ranillug do të ndikojë në procesin e decentralizimit dhe në krijimin e komunave të reja të Mitrovicës së Veriut dhe të Parteshit. Derisa Mitrovica e Veriut do të shikojë zhvillimet në Graçanicë, serbët e Parteshit do t'i shikojnë zhvillimet në dy komunat e tjera.

Funksionaliteti i këtyre qeverive komunale jo vetëm që siguron mirëqenien e banorëve të tyre, që kryesisht janë serbë të Kosovës, por gjithashtu është hapi i parë thelbësor institucional drejt përfshirjes së përgjithshme të serbëve në shoqërinë e Kosovës. Suksesi i tërë procesit të decentralizimit varet na kjo fazë, e po ashtu varet edhe funksionaliteti i komunave të reja, të cilat në fazën e fundit të këtij procesi do të fitojnë një listë të zgjeruar të kompetencave në përputhje me Propozimin gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës.<sup>1</sup> Për më tepër, e tërë ideja e Kosovës si një shtet shumetnik dhe shumëkulturore varet nga decentralizimi dhe krijimi i komunave të reja.

### a) Gjendja e tanishme

Komuna e Graçanicës, Kllokot/Vërbovcit dhe ajo e Ranillugut, në aspektin infrastrukturor i përkasin kategorisë së komunave rurale dhe nuk kanë kapacitete të menjëhershme për t'u urbanizuar.

Në Graçanicë shërbimet komunale udhëhiqen nga kompanitë regionale të shërbimeve komunale. Shërbimet komunale në atë pjesë janë të ngjashme me vendet e tjera rurale në Kosovë që vuajnë nga shërbimet shumë të dobëta komunale. Në Kllokot/Vërbovc dhe në Ranillug asnjëra prej fshatrave nuk kanë ujësjellës, kanalizim apo sistem për grumbullimin e mbeturinave. Të gjitha këto shërbime menaxhohen pjesërisht nga fshatarët e vetorganizuar.

Mungesa e infrastrukturës do të jetë sfida e parë, me të cilën do të ballafaqohen autoritetet e sapozgjedhura komunale. Qeveria e Kosovës e pranon faktin se mund të nevojiten disa vjet para se këto komuna të bëhen plotësisht funksionale.<sup>2</sup> Popullata serbe në Graçanicë, Kllokot/Vërbovc dhe në Ranillug kanë shpresa të mëdha tek autoritetet e reja komunale, të cilat gjatë fushatës zgjedhore kanë bërë shumë premtime, duke filluar nga projektet themelore infrastrukturore deri te punësimi dhe zhvillimi ekonomik.<sup>3</sup> Çfarëdo zhgënjimi nga serbët ndaj përfaqësuesve të tyre të zgjedhur do të ketë pasoja më të mëdha se sa vetëm ato në nivelin lokal, pasi që gjithashtu do të ndikojë në procesin e decentralizimit.

Asnjë nga komunat e sapokrijuara nuk kanë ndërtesa komunale, përveç Kllokotit/Vërbovcit, ku mjediset e objektit komunal tanimë janë në ndërtim e sipër.

---

<sup>1</sup> *Kosova në udhëkryq – Decentralizimi*, KIPRED, Prishtinë, korrik 2009.

<sup>2</sup> KIPRED, intervistë me zyrtarin e MAPL-së, Prishtinë, dhjetor 2009.

<sup>3</sup> KIPRED, intervistë me përfaqësuesit e MPT-së dhe të shoqërisë civile, Graçanicë, nëntor – dhjetor 2009.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka ndarë fonde për ndërtimin e objektit të kuvendit komunal. Megjithatë, ky proces ka mundësi të zgjasë, dhe në ndërkohë qeveritë lokale do të vendosen në objektet e marra me qira<sup>4</sup>. Problemet e tjera administrative ka gjasë të dalin brenda ditëve të para pasi që këto komuna të bëhen funksionale, ndërsa mbledhjet e kuvendit komunal do të organizohen në objekte të ndryshme.

Bujqësia është profesioni më i rëndësishëm për popullatën e këtyre komunave. Shumica e familjeve jetojnë në vendet rurale dhe kryesisht varen nga bujqësia si bazë për aktivitetin e tyre ekonomik. Një përparësi për të tri komunat është toka pjellore. Bujqit serbë ankohen se nuk mund t'i shesin produktet e tyre në vendbanimet shqiptare, ndërsa është edhe më vështirë që t'i shesin ato në Serbi për shkak të transportit ndërkufitar dhe doganës që duhet të paguhet. Si pasojë, shumë familje varen nga punësimi ose ndihmat që vinë nga strukturat paralele të Serbisë. Ata që kanë qenë të punësuar në kompanitë publike para vitit 1999 marrin ndihmë sociale nga Republika e Serbisë. Serbët më të vjetër se 65 vjeç marrin pensione si nga autoritetet e Serbisë, ashtu edhe nga ato të Kosovës.

Ekzistojnë disa biznese të vogla që punojnë në këto komuna, shumica e tyre në Graçanicë. Megjithatë, këto biznese janë të përqendruara në nivel të ulët të tregtisë, ndërsa nuk ekzistojnë ndërmarrje të mesme apo të mëdha.

Strategjitë për zhvillimin ekonomik, duke përfshirë ato për tërheqjen e investimeve, dhe përkrahja e donatorëve janë sfida e parë, me të cilën do të ballafaqohen autoritetet e reja. Një investim i menjëhershëm infrastrukturor pritet të vjen nga buxheti komunal, ndërsa sfidat administrative për qeveritë komunale do të dalin pas themelimit të tyre.

## **b) Strukturat paralele**

Përveç çështjeve infrastrukturore dhe ekonomike, një nga sfidat më të mëdha për komunat e reja, por edhe për ato ekzistueset, është e natyrës politike. Ekzistenca e strukturave paralele politike dhe administrative, por edhe të atyre të punëve të brendshme dhe të shërbimit të zbulimit, do të shkaktojnë një ballafaqim të pashmangshëm me politikën dhe qeverisjen e autoriteteve të sapozgjedhura komunale, duke krijuar kështu një tension politik dhe shoqëror.

Në Graçanicë ekzistojnë tri autoritete të ndryshme komunale të strukturave paralele. Institucionet e arsimit dhe ato shëndetësore, si dhe administrata paralele komunale financohen dhe kontrollohen nga "komunat" paralele të Prishtinës, Lipjanit dhe të Fushë Kosovës. Në Klokot/Vërbovc funksionon "komuna" paralele e Vitisë, ndërsa në Ranillug, "komuna" paralele e Kamenicës.

Këto "komuna" paralele kontrollojnë administratën paralele publike dhe shëndetësinë e arsimin. Ekzistojnë 16 punkte shëndetësore në territorin e komunës së Graçanicës, 11 prej të cilave financohen nga strukturat paralele. Që të tri institucionet e kujdesit dytësor shëndetësor në Graçanicë financohen nga strukturat paralele, ndërsa dy spitale, njëri në Graçanicë dhe tjetri në Laplesellë, financohen nga Qeveria e Kosovës dhe nuk marrin ndonjë ndihmë nga autoritetet e Beogradit. Në Ranillug janë dy objekte të kujdesit parësor shëndetësor dhe 3 punkte shëndetësore. Të gjitha atyre u mungon hapësira, kanë

---

<sup>4</sup> KIPRED, intervistat me anëtarët e[EPK-ve në Graçanicë, dhjetor 2009.

infrastrukturë të vjetër dhe pajisje joadekuatë. Shumica e të punësuarve paguhen nga Serbia.

Në sektorin e arsimit, në Graçanicë ekzistojnë 13 shkolla fillore dhe 8 shkolla të mesme, dhe 3 shkolla fillore dhe 1 e mesme në Kllokot/Vërbovc – të gjitha të kontrolluara dhe të financuara nga Beogradi. Në Ranillug ekzistojnë 9 shkolla fillore dhe 4 të mesme.

Qeveritë e reja komunale në mënyrë të pashmangshme do të ballafaqohen me strukturat paralele, pikësëpari në fushën e arsimit dhe të shëndetësisë, të cilat, sipas Ligjit të Kosovës për vetëqeverisje lokale, janë kompetenca ekskluzive të komunave.<sup>5</sup> Kjo do të jetë sfidë e madhe, dhe në afat të shkurtër gjithashtu e pamundshme, që komunat e reja t'i vendosin këto institucione nën kontrollin e tyre, duke pasur parasysh se ato kanë funksionuar nën qeverinë e Serbisë që një dekadë. Sfidë është edhe më e madhe në sistemin e arsimit, pasi që shkollat punojnë sipas planprogrameve të Serbisë, dhe në shumë raste refuzojnë çfarëdolloj ndihmese nga autoritetet e Kosovës.

Qeveria e Kosovës, përmes buxhetit të ndarë për ministritë në nivelin qendror, do të investojë më shumë se 1 milion euro në këto tri komuna me shumicë serbe, duke mos i llogaritur këtu investimet që parashihet të vinë përmes autoriteteve komunale<sup>6</sup>. Megjithatë, as Qeveria e Kosovës e as bashkësia ndërkombëtare nuk kanë ndonjë strategji se si të trajtojnë strukturat paralele.

Dalja e serbëve në zgjedhjet e 15 nëntorit 2009 në të gjitha këto komuna ishte pak më e lartë sesa dalja në zgjedhjet paralele të organizuara nga Republika e Serbisë. Qeveria e Serbisë e konsideroi këtë si tregues se ndikimi i Beogradit në Kosovë është tundur.<sup>7</sup> Një numër i udhëheqësve të Kosovës, që janë të punësuar në strukturat paralele të Serbisë, kanë deklaruar publikisht se janë në favor të decentralizimit<sup>8</sup>. Fakti se disa personalitete mirë të njohura publike garonin në zgjedhjet e 15 nëntorit, tregon ndryshim në disponimin e përgjithshëm të serbëve të Kosovës lidhur me procesin e decentralizimit. Pas kësaj, qeveria e Serbisë tani po thotë se nuk e kundërshton procesin e decentralizimit, por që ende vazhdon ta kundërshton Propozimin gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës.<sup>9</sup> Megjithatë, Beogradi ka deklaruar se nuk do të bashkëpunojë e as që do t'i përkrahë komunat e reja.

### **c) Planifikimi dhe financat**

Partitë politike serbe që garonin në zgjedhjet e 15 nëntorit i premtuan zgjedhësve të tyre se do t'i zgjidhin të gjitha problemet e tyre të përditshme menjëherë pas marrjes së detyrës.<sup>10</sup> Këto premtime të tepruara konsiderohet se janë dhënë për shkak të mungesës

---

<sup>5</sup> Ligji për vetëqeverisjen lokale, neni 17, kompetencat vetanake.

<sup>6</sup> Propozimbuxheti i Kosovës për vitin 2010.

<sup>7</sup> Partia e Thaçit deklaroi se ka fituar në zgjedhjet lokale, B92, Beograd, [http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2009&mm=11&dd=16&nav\\_id=63068](http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2009&mm=11&dd=16&nav_id=63068), qasur më 21 dhjetor 2009.

<sup>8</sup> Rada Trajković, Rangjell Nojkić, Dragan Velić, Momčilo Trajković, etj.

<sup>9</sup> Ministri për Kosovën takohet me serbët lokalë, B92, Beograd, [http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2009&mm=12&dd=17&nav\\_id=63831](http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2009&mm=12&dd=17&nav_id=63831) qasur më 21 dhjetor 2009.

<sup>10</sup> KIPRED, intervistat me serbët në Graçanicë, nëntor – dhjetor 2009, dhe një intervistë me një diplomat të lartë në Kosovë, Prishtinë, dhjetor 2009.

së përvojës së tyre politike dhe për shkak të dëshirës për të mbledhur sa më shumë vota që të jetë e mundur<sup>11</sup>. Këto premtime ishin në përputhje me pritjet e serbëve, që dëshirojnë të shohin përmirësime në jetën e tyre. Megjithatë, autoritetet komunale nuk do t'i kenë as kapacitetet e as buxhetin për t'i realizuar këto premtime.

Sipas propozimbuxhetit të Kosovës për vitin 2010<sup>12</sup>, i cili pritet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës, komuna e **Graçanicës** do të ketë një buxhet vjetor prej 1,791,035 €, nga të cilat 110,214 € janë planifikuar për mëditjet dhe pagat e 37 punonjësve administrativë që do t'i ketë kjo komunë, 1,144,695 € për mallrat dhe shërbimet dhe 536,126 € për investime kapitale. Buxheti ndahet nga tri grante kryesore të Qeverisë së Kosovës, gjegjësisht nga granti i përgjithshëm prej 1,183,221 €, grantit specifik për arsim në shumë prej 401,058 € dhe nga granti specifik për shëndetësi prej 206,757 €.<sup>13</sup>

**Komunës së Kllokotit/Vërbovcit** i është ndarë një buxhet prej 719,602€, nga të cilat 85,166€ për mëditje dhe paga, 351,464€ për mallra dhe shërbime dhe 282,972€ për shpenzime kapitale. Ky buxhet përbëhet prej granteve si në vijim: granti i përgjithshëm me 402,674€, granti për arsim 266,553€ dhe granti për shëndetësi prej 50,375€.<sup>14</sup>

**Ranillugu** do ta ketë një buxhet prej 693,636€, nga të cilat 85,299€ për mëditje dhe paga, 368,185€ për mallra dhe shërbime dhe 240,151€ për shpenzime kapitale. Grantet që përbëjnë këtë buxhet janë: granti i përgjithshëm me 417,787€, granti për arsim 220,883€ dhe granti për shëndetësi 54,956€.<sup>15</sup>

Numri i punonjësve në komunat e reja<sup>16</sup>, krahasuar me atë të komunave ekzistuese<sup>17</sup>, është shumë i ulët dhe vetëm përfshinë punonjësit administrativë të komunës. Vija buxhetore për “mallra dhe shërbime” në komunat e reja është shumë e lartë, ndërsa vija buxhetore për “mëditjet dhe pagat” është shumë e ulët. Në bazë të ligjit, qeveritë komunale janë përgjegjëse për ekzekutimin e mëditjeve dhe pagave për të gjithë punonjësit publikë, duke përfshirë mësimdhënësit, mjekët dhe motrat mjekësore, si dhe për tërë administratën publike.<sup>18</sup> Kjo nuk ndodh në komunat e reja, pasi që shërbyesit publikë janë gjithashtu të punësuar në sistemin paralel të Serbisë dhe janë pjesë e institucioneve paralele. Do të jetë përgjegjësi e qeverive komunale të shohin sesi do të përfshijnë këta shërbyes civilë në sistemin e Kosovës.<sup>19</sup> Qeveritë komunale duhet të

---

<sup>11</sup> Po aty.

<sup>12</sup> Propozimbuxheti i Kosovës për vitin 2010.

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> Po aty.

<sup>16</sup> Graçanicë, Kllokot/Vërbovc dhe Ranillug.

<sup>17</sup> Shtërpcë dhe Novobërdë.

<sup>18</sup> Ligji për vetëqeverijen lokale.

<sup>19</sup> KIPRED, intervistë me një zyrtar të MAPL-së, Prishtinë, dhjetor 2009.

respektojnë grantet buxhetore në kuptim të shpenzimeve të dedikuara për shëndetësi dhe arsim, bazuar në grantet e dhëna nga Qeveria.<sup>20</sup>

Për vitin 2010, komuna e **Shtërpcës** do të ketë buxhetin prej 1,720,963€, nga të cilat 966,636€ për mëditiqe dhe paga, 126,214€ për mallra dhe shërbime, 32,120€ për shpenzime komunale, 5,000€ për transfere dhe subvencione dhe 590,993€ për shpenzime kapitale. Grantet që vijnë nga Qeveria e Kosovës për këtë komunë janë: granti i përgjithshëm 884,507€, granti për arsim 639,450€ dhe granti për shëndetësi 130,094€.<sup>21</sup>

Në anën tjetër, buxheti i **Novobërdës** për vitin 2010 është 1,468,090€, nga të cilat 685,375€ janë të dedikuara për mëditiqet dhe pagat, 60,375€ për mallra dhe shërbime, 23,500€ për shpenzime komunale, 16,000€ për subvencione dhe transfere dhe 682,440€ për shpenzime kapitale.<sup>22</sup> Granti i përgjithshëm nga buxheti kap shumën prej 793,174€, ku granti për arsim është 502,888€, ndërsa granti për shëndetësi kap shumën prej 117,414€.<sup>23</sup>

#### Financat e komunave veriore

Ekziston një bindje e përhapur se komunat veriore të kontrolluara nga serbët Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku nuk bashkëpunojnë me institucionet e Kosovës. Megjithatë, në planin buxhetor për vitin 2010, Qeveria e Kosovës ka ndarë një shumë të rregullt financiare për funksionimin e këtyre komunave.

**Leposaviqi** është komunë, së cilës Qeveria e Kosovës ia ka ndarë buxhetin prej 2,129,276€ për vitin 2010, nga të cilat 1,244,292€ si grant i përgjithshëm, 664,060€ si grant për arsim dhe 195,354€ si grant për shëndetësi.<sup>24</sup> Në bazë të vijave buxhetore, investimet kapitale në këtë komunë do të jenë 521,859€, ndërsa komuna ka 447 punonjës që paguhen nga buxheti i Kosovës, në shumë të përgjithshme prej 1,237,965€.<sup>25</sup>

**Zveçani** në vitin 2010 do të marr nga buxheti i Kosovës shumën e përgjithshme prej 1,503,662€, nga të cilat 933,546€ si grant i përgjithshëm, 340,733€ si grant për arsim dhe 164,805€ si grant për shëndetësi.<sup>26</sup> Kjo komunë ka 232 punonjës që do të paguhen nga buxheti i Kosovës.<sup>27</sup>

**Zubin Potoku** do të ketë buxhetin prej 1,590,485€ të ndarë nga Qeveria e Kosovës për vitin 2010, nga të cilat 975,000€ janë grant i përgjithshëm, 396,716€ si grant për arsim dhe 154,424€ si grant për shëndetësi.<sup>28</sup> Komuna ka 327 punonjës që paguhen nga buxheti i Kosovës.<sup>29</sup>

#### **e) Tensionet me Qeverinë qendrore**

---

<sup>20</sup> Qeveria e Kosovës do t'u jep komunave të reja nga tre grante, nga të cilat dy janë specifike për arsim dhe shëndetësi dhe një grant është i përgjithshëm.

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> Propozimbuxheti i Kosovës për vitin 2010.

<sup>25</sup> Po aty.

<sup>26</sup> Po aty.

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> Po aty.

<sup>29</sup> Po aty.



Kryetarët e zgjedhur të komunave tanimë i janë ankuar autoriteteve qendrore dhe bashkësisë ndërkombëtare lidhur me shpërndarjen e buxhetit dhe kushtet për funksionalitetin e plotë të qeverive lokale.<sup>30</sup>

Buxheti që është ndarë gjithashtu llogaritet si i pamjaftueshëm për fillimin e punës së komunave. Komunitet e reja mund të krijojnë të hyra vetanake përmes tatimeve komunale, taksave dhe pagesave të ndryshme, qirasë për pronat e paluajtshme, granteve nga donatorët e ndryshëm, duke përfshirë edhe grantet e mundshme nga Republika e Serbisë.<sup>31</sup> Megjithatë, të hyrat vetanake nuk janë të parapara në propozimbuxhetin e Kosovës për vitin 2010 për komunat e Graçanicës, Klllokotit/Vërbovcit dhe Ranillugut.

Sidoqoftë, MAPL-ja ka buxhetin shtesë deri në 3 milionë € për ndërtimin e kapaciteteve të komunave të reja, për ndërtimin e objekteve komunale dhe për përkrahjen e projekteve të ndryshme të komunave.<sup>32</sup> Komuniteti i donatorëve, posaçërisht USAID-ja, kanë treguar interes të menjëhershëm për të investuar në projekte në komunat e reja. Sfidë tjetër për këto komuna do të jetë mungesa e kapaciteteve për thithjen e granteve të mundshme dhe kapacitete të përgjithshme të dobëta për shpenzime për shkak të mungesës së punonjësve profesionalë, të përvojës dhe të infrastrukturës së duhur.

Serbët e Kosovës kanë bojkotuar zgjedhjet e organizuara nga autoritetet e Kosovës edhe në komunën e Novobërdës dhe të Shtërpçës, të cilat kanë popullatë të përzier etnike. Si rezultat i kësaj, Novobërda ka pasur kryetarin shqiptar të komunës pasi që popullata shqiptare morri pjesë në zgjedhje.

Shtërpca në anën tjetër kishte një situatë ku tre politikanë pretendonin se janë kryetarë të komunës. I pari ishte Beqir Fejzullahu, politikan shqiptar që fitoi shumicën e votave në zgjedhjet e vitit 2007, por për shkak të bojkotit serb, Qeveria e Kosovës vendosi t'ia zgjasë mandatin Stanko Jakovleviqit, i cili ishte kryetari i zgjedhur i komunës në vitin 2002. Nga ana tjetër, 'komuna' paralele udhëhiqej nga Zvonko Mihajloviq. Kjo situatë kryesisht është zgjidhur pas zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit dhe balotazhit për kryetarë komune më 13 dhjetor, ku përveç daljes shumë të lartë të serbëve në zgjedhje, kandidati i SLS-së u bë kryetar i komunës. SLS-ja ka gjithashtu 8 ulëse nga gjithsej 19 sosh në kuvendin komunal.<sup>33</sup>

Buxheti i planifikuar për vitet 2010-2012 për të tri këto komuna parasheh vetëm një shumë simbolike si të hyra vetanake të komunave.<sup>34</sup> Të gjitha këto komuna qeverisen nga kuvendet dhe kryetarët e komunave që janë zgjedhur në zgjedhjet lokale të Kosovës të vitit 2002. Që nga ajo kohë, mandati i tyre është zgjatuar vazhdimisht për shkak të faktit se serbët kanë bojkotuar zgjedhjet e organizuara nga autoritetet e Kosovës. Pas bojkotit të zgjedhjeve të vitit 2004, misioni i OKB-së në Kosovë (UNMIK) ua zgjati mandatet kryetarëve të komunave dhe kuvendeve komunale të Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut, por gjithashtu edhe të Novobërdës dhe Shtërpçës. Kryeministri i Kosovës vendosi për një zgjatje tjetër në dhjetor të vitit 2007, pasi që serbët bojkotuan zgjedhjet

---

<sup>30</sup> Deklaratat e kryetarit të Graçanicës, Bojan Stojanović, dhe kryetarit të komunës së Ranillugut, Gradimir Mikić.

<sup>31</sup> Ligji për financat lokale, neni 8.

<sup>32</sup> KIPRED, intervistë me zyrtarin e lartë të MAPL-së, Prishtinë, dhjetor 2009.

<sup>33</sup> Për informata rreth historikut, luteni të lexoni raportin e KIPRED-it "Decentralizimi në Kosovë I: Serbët dhe zgjedhjet komunale" XXXX.

<sup>34</sup> Po aty.

për herë të dytë. Nga ana tjetër, gjendja politike në këto komuna ka ndryshuar dukshëm që nga viti 2002.

### III. Komunat e ardhshme – Mitrovica e Veriut dhe Parteshi

Autoritetet e Kosovës dhe Zyra Ndërkombëtare Civile (ICO) janë të obliguara t'i ndërmarrin të gjitha përgatitjet e nevojshme që të sigurohen se deri në kohën e zgjedhjeve lokale të majit 2010, burimet, pronat dhe strukturat administrative të kërkuara për themelimin dhe funksionimin e komunave të reja të jenë ndarë dhe themeluar.<sup>35</sup> Pas krijimit të komunave të reja, të Graçanicës, Kllokotit/Vërbovcit dhe të Ranillugut, ICO-ja deklaroi se decentralizimi në Partesh dhe në Mitrovicën e Veriut do të vazhdojë dhe se zgjedhjet atje do të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj pas datës 16 nëntor 2009.<sup>36</sup> Kryetari i Kosovës është i obliguar të shpall datën e zgjedhjeve së paku 4 muaj përpara apo më së voni deri më 15 janar 2010.<sup>37</sup> Kjo lë kohë të shkurtër për autoritetet që t'i sigurojnë përgatitjet për zgjedhjet si në nivelin politik, ashtu edhe në atë teknik.

EPK-ja për Partesh tanimë është emëruar dhe është duke punuar rreth përgatitjeve për krijimin e komunës së re.<sup>38</sup> Në përgjithësi, deri më tani klima për themelimin e komunës është e volitshme, përderisa rezistenca politike e disa serbëve lokalë lidhur me procesin e decentralizimit është duke u dobësuar dhe zhdukur.<sup>39</sup> Megjithatë, ekzistenca e strukturave paralele mbetet sfidë për këtë komunë të ardhshme, ngjashëm siç është rasti i Graçanicës, Kllokotit/Vërbovcit dhe i Ranillugut.

Në propozimbuxhetin për vitin 2010, Qeveria e Kosovës ka ndarë buxhetin prej 742,246€ për Parteshin, nga të cilat 88,173€ për mëditje dhe paga, 361,363€ për mallra dhe shërbime dhe 292,719€ për shpenzime kapitale.

Autoritetet e Kosovës nuk kanë paraparë buxhet për komunën e Mitrovicës së Veriut. Në propozimbuxhetin ekziston vija buxhetore për këtë komunë, por nuk janë ndarë mjete financiare për të.<sup>40</sup> Buxheti për këtë komunë, për dallim nga komunat e tjera dhe Parteshi, fillimisht do të vjen nga buxheti i ndarë për komunën e tanishme të Mitrovicës.<sup>41</sup> Fakti që autoritetet nuk e kanë trajtuar Mitrovicën e Veriut njëjtë si Parteshin në këtë fazë, duke ditur se statusi aktual politik i të dy komunave të ardhshme është plotësisht i njëjtë, është sinjal i keq që po u dërgohet serbëve të Kosovës që jetojnë në pjesën veriore të Mitrovicës. Megjithatë, Qeveria e Kosovës vazhdon të financojë Administratën në Mitrovicë (AM) të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

---

<sup>35</sup> Propozimi gjithëpërfshirës për statusin, shtojca III, neni 12, pika 1.

<sup>36</sup> Komunikatë e ICO-së, 15 shtator 2009.

<sup>37</sup> Ligji për zgjedhjet lokale, neni 4.3

<sup>38</sup> KIPRED, intervistë me zyrtarin e ICO-së, Prishtinë, dhjetor 2009.

<sup>39</sup> Po aty.

<sup>40</sup> Propozimbuxheti i Kosovës për vitin 2010.

<sup>41</sup> KIPRED, intervistë me përfaqësuesin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Prishtinë, dhjetor 2009.

(UNMIK), duke ndarë 2,5 milionë euro në vit. Administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë funksionon si komunë de fakto e Mitrovicës së veriut; ka tetë departamente dhe 123 punonjës. Administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë i raporton drejtpërsëdrejti UNMIK-ut.

Krijimi i komunës së Mitrovicës së Veriut mbetet sfida më e madhe për autoritetet e Kosovës dhe për bashkësinë ndërkombëtare. Deri më tani, ICO-ja ka intervistuar aplikuesit për pozitat e EPK-së për këtë komunë dhe ka vendosur t'i rishpallë konkurset, pasi që ishte e pakënaqur me kapacitetet e atyre që aplikuan për këto pozita.<sup>42</sup> Konkursi ka gjasë që të mos ketë sukses për herë të dytë pasi që serbët lokalë në Mitrovicë janë të dekurajuar nga aplikimi. Për më tepër, ata ngacmohen dhe kërcënohen për të mos aplikuar nga strukturat paralele të sigurisë të Serbisë që veprojnë në veri.<sup>43</sup> Derisa këto struktura të veprojnë lirshëm në atë rrethinë, krijimi i komunës së re të Mitrovicës së Veriut dhe procesi i decentralizimit në Kosovë mbesin të rrezikuara.

#### **a) Kosova e veriut mes pritjeve ndërkombëtare dhe realiteteve vendore**

Bashkësia ndërkombëtare nuk sheh as vazhdimësi e as ndonjë plan afatgjatë në qëndrimin dhe politikën e tanishme të Qeverisë së Serbisë drejt Kosovës.<sup>44</sup> Ende nuk ka tregues se Serbia do ta ndryshon politikën e saj lidhur me ekzistimin e strukturave paralele, megjithëse me kalimin e kohës Beogradi gradualisht mund ta tërheq përkrahjen ndaj këtyre institucioneve në vendbanimet serbe në jug të lumit Ibër. Përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MUP) të Serbisë ka gjasë se do të vazhdojnë me ngacmime dhe kërcënime ndaj gjithë atyre serbëve në veri që punojnë drejt integritimit në shoqërinë e Kosovës.

Prania ndërkombëtare në Kosovë nuk sheh ekzistimin e strukturave paralele si një pengesë në këtë fazë. Qëndrimi i tyre i tanishëm është t'u bëjnë presion autoriteteve të Kosovës që të kenë një ofertë konkrete dhe të shpejtë në terren për serbët lokalë<sup>45</sup>. Ata mendojnë se serbët do të pranojnë dhe madje edhe të mirëpresin çfarëdo investimi të autoriteteve të Kosovës, përmes autoriteteve të sapozgjedhura komunale.<sup>46</sup> Por serbët janë të ndarë kur kemi të bëjmë me këtë lloj çështjesh. Ndikimi i Qeverisë së Beogradit mbi ta, edhe pse dalëngadalë po humb, ende mbetet i fortë përmes ngacmimeve dhe kërcënimeve. Strukturat paralele të punëve të brendshme dhe të shërbimit të zbulimit, vazhdojnë të ngacmojnë dhe kërcënojnë të gjithë ata serbë që janë të gatshëm të bashkëpunojnë me institucionet e Kosovës. Kjo paraqet sfida serioze për çfarëdo zhvillimi pozitiv në veri.

Ekziston një nivel i pabazë i optimizimit në mesin e pranisë ndërkombëtare lidhur me themelimin e komunës së Mitrovicës së Veriut. ICO-ja dhe anëtarët e Kuintit e shohin zgjidhjen përmes rolit të Qeverisë së Beogradit në terren. Shumica e udhëheqësve të tanishëm të strukturave paralele në veri i përkasin Partisë Demokratike të Serbisë (DSS) të ish-kryeministrit Vojislav Koshtunica. Partia më e madhe e koalicionit qeveritar në Serbi, Partia Demokratike (DS), e udhëhequr nga kryetari, Boris Tadić, tani është duke

---

<sup>42</sup> KIPRED, intervistë me përfaqësuesit e ICO-së dhe të MAPL-së, Prishtinë, dhjetor 2009.

<sup>43</sup> KIPRED, intervistat me gazetarë dhe me përfaqësues të shoqërisë civile në Mitrovicë, nëntor – dhjetor 2009.

<sup>44</sup> KIPRED, intervistë me diplomatin e lartë evropian, Hagë, dhjetor 2009.

<sup>45</sup> KIPRED, intervistë me zyrtarin e lartë të ICO-së, Prishtinë, dhjetor 2009.

<sup>46</sup> Po aty.

zëvendësuar zyrtarët kryesorë të strukturave paralele në veri me njerëzit e vet.<sup>47</sup> Ka mundësi të mira që komunat paralele në veriun e Kosovës do të vendosen nën administrimin e përkohshëm, që do të udhëhiqet nga të emëruarit e Tadiqit.<sup>48</sup> Bashkësia ndërkombëtare e sheh këtë lëvizje si një shenjë pozitive, e cila do të ndihmon procesin e decentralizimit dhe do t'i ndihmon ICO-së për të marrë pajtimin e serbëve vendorë lidhur me krijimin e komunës së re.

Megjithatë, këto pritje nuk janë realiste. Që nga fillimi i punës së doganierëve të misionit për sundimin e ligjit të BE-së (EULEX) në dy pikat veriore kufitare, portën 1 dhe 31, përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare në Mitrovicë kanë stagnuar. Kjo ka krijuar më shumë hapësirë për zgjerimin e strukturave paralele të Beogradit në veri. Në këtë frymë, vendbanimet me shumicë serbe në veri, duke përfshirë pjesën veriore të Mitrovicës, janë shkyçur nga rrjeti elektrik i Kosovës i KEK-ut dhe janë lidhur me korporatën kryesore energjetike të Serbisë Elektro-Privreda Srbije (EPS), e cila tani punon në mënyrë të paligjshme në Kosovë. EPS-ja do të bëjë inkasimin e faturave në veri, edhe pse nuk do të jetë në gjendje që gjithmonë të ofrojë rrymë për veriun.

Në Zubin Potok janë dy kryetarë të komunave. Njëri prej tyre, Sllavisha Ristiç, është zgjedhur në zgjedhjet e Kosovës në vitin 2002, dhe mbetet përgjegjës për administrimin e buxhetit të dhënë nga Qeveria e Kosovës. Megjithatë, rrallë ndodh që në këtë komunë të zbatohet çfarëdo politike qeveritare. Nga ana tjetër, më 11 maj të vitit 2008 Serbia organizoi zgjedhjet në Kosovë, nga të cilat është krijuar komuna paralele. Udhëheqësi i kësaj komune është Stevan Bozhoviq. Si z. Ristiç, ashtu edhe z. Bozhoviq janë anëtarë të Partisë Demokratike të Serbisë (DSS), të udhëhequr nga ish-kryeministri i Serbisë, Vojislav Koshtunica. Ata të dy janë udhëheqës të komunës së Zubin Potokut në kuadër të sistemeve të ndryshme. Faqja zyrtare e internetit e komunës<sup>49</sup>, që është me emërtim të domenit me shkronjat .RS<sup>50</sup> paraqet komunën e Zubin Potokut të Kosovës, edhe pse emërtimi i domenit është ai zyrtar i Serbisë.

Në Zveçan gjendja është pak më ndryshe, pasi që në ndërkohë ekuilibri i forcave politike ka ndryshuar në masë të madhe. Kryetari i kësaj komune, mandati i të cilit është zgjatur nga autoritetet e Kosovës është Dragisha Milloviq, i cili vjen nga DSS-ja. Megjithatë, pas zgjedhjeve të 11 majit 2008 të organizuara nga Serbia, përkrahja për DSS-në komunë ka rënë, ndërsa shumicën e votave në komunën serbe i morri Partia Radikale Serbe (SRS) e udhëhequr nga Vojislav Sheshel, i cili është duke u gjykuar në Hagë për krime të luftës. Udhëheqësi i komunës paralele të Zveçanit është Dobrosav Dobriq nga SRS-ja.

Në nëntor të vitit 2009, Serbia organizoi zgjedhjet e hershme për komunën e saj paralele të Leposaviqit. Rezultatet treguan se Partia Demokratike të Serbisë e kryetarit Boris Tadiq fitoi shumicën e vendeve në këtë kuvend paralel të komunës, i cili më parë udhëhiqej nga DSS-ja e Koshtunicës. Megjithatë, kryetari i komunës ligjore, mandati i të cilit është zgjatur nga autoritetet e Kosovës, mbetet Vellimir Bojoviq, i cili vjen nga DSS-ja.

Që nga viti 2004, është dëshmuar qartazi se Qeveria e Prishtinës nuk ka mundur ta shtrijë pushtetin e saj në veri, duke ua zgjatur mandatet kryetarëve të komunave që ishin zgjedhur në vitin 2002. Për më tepër, këta kryetarë të komunave vinë nga partia DSS e

---

<sup>47</sup> KIPRED, intervistë me zyrtarin e lartë ndërkombëtar, Prishtinë, dhjetor 2009.

<sup>48</sup> Po aty.

<sup>49</sup> <http://www.zubin-potok.org.rs> qasur më 22 dhjetor 2009.

<sup>50</sup> RS do të thotë Republika e Serbisë.

Koshtunicës, një entitet politik ky që nuk e ka më përkrahjen e serbëve vendorë. Kjo ka çuar në formimin e mendimit në qarqet diplomatike se autoritetet në Prishtinë janë pajtuar me faktin se nuk mund ta kontrollojnë veriun e Kosovës, mu sikurse mënyra sesi është pajtuar Qeveria e Beogradit se kurrë më nuk mund ta kontrollojë Kosovën.<sup>51</sup> Këto përfundime nuk janë vetëm kundër parimeve të grupit të Kontaktit, por edhe korrespondojnë me planin e Serbisë për ndarje të Kosovës pas vendimit të GjND-së.

Udhëheqësia në Beograd mbetet e përkushtuar qëllimit të saj strategjik për ndarjen e Kosovës pasi që në pjesën e parë të vitit 2010 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND) të lëshon mendimin këshillëdhënës për ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, duke besuar se ky mendim do të jetë në favorin më të mirë të qëndrimit të Serbisë, dhe se do të hap rrugën për një raund të ri të negociatave me udhëheqësinë e Kosovës, të cilat në fund të rezultojnë me ndarjen e negociuar të Kosovës.<sup>52</sup> Prishtina, në anën tjetër, nuk ka qëndrim të vetin lidhur me hapat pas përfundimit të procesit në GjND.

Më 16 tetor 2009, BE-ja emëroi ambasadorin italian në Kosovë, Mikele Gjifoni (Michele Giffoni) si përfaqësues special i BE-së për Kosovën e veriut. Ai do të punojnë sipas udhëzimeve të Përfaqësuesit Special të BE-së (PSBE) në Kosovë. Megjithatë, mbetet e paqartë se cilat janë objektivat që ai parashihet t'i arrijë.

Suksesi që komunat jugore mund ta kenë në të ardhmen e afërt nuk është i mjaftueshëm për ndryshimin e gjendjes politike në veri në mesin e serbëve vendorë, për sa kohë që institucionet paralele të sigurisë të jenë të pranishme. Në rastin më të mirë, vetëm 5% të serbëve në Mitrovicën e veriut tani për tani do të marrin pjesë në zgjedhjet komunale të organizuara nga Kosova.<sup>53</sup>

Serbët në veri kryesisht janë të shqetësuar për perspektivën ekonomike<sup>54</sup>. Rrjedhimisht, çfarëdo gjendjeje politike për krijimin e komunës së re duhet të përcillet me një ofertë për zhvillimin ekonomik. Kjo mundësi nuk është shfrytëzuar nga Qeveria e Kosovës për të zhvilluar dhe ofruar një zgjidhje të kombinuar politike dhe ekonomike për këtë pjesë të Kosovës. Pra, vetëm një strategji e tillë do të ofronte mundësinë për përfshirjen graduale të Kosovës së veriut në pjesën tjetër të kornizës institucionale.<sup>55</sup>

Përpjekjet e tilla nuk do të jenë të suksesshme nëse bashkësia ndërkombëtare, kryesisht EULEX-i, dhe institucionet e Kosovës mbesin pa vizion për Kosovën e veriut. ICO-ja tani për tani po zbaton formulën për ndryshimin gradual në Mitrovicën e veriut, që do të bazohet në rezultatet pozitive në komunat jugore.<sup>56</sup> Kjo pikëpamje përkrahet nga shtete e Kuintit, ndërsa EULEX-i ende nuk është i aftë për ndërmarrjen e çfarëdo veprimi serioz për krijimin e sundimit të ligjit në atë vend. Nga ana tjetër, qëndrimi i Beogradit dallon për veriun me atë për komunat në jug të lumit Ibër.

---

<sup>51</sup> KIPRED, intervistë me një diplomat të lartë të BE-së, Hagë, dhjetor 2009.

<sup>52</sup> Kosova në udhëkryq – Decentralizimi, KIPRED, korrik, 2009.

<sup>53</sup> Sjellje e parregullt: Qeveria në Mitrovicë, Nisma për Stabilitet e Kosovës, dhjetor 2009.  
[http://www.iksweb.org/repository/docs/policy\\_brief\\_mitrovica\\_governance.pdf](http://www.iksweb.org/repository/docs/policy_brief_mitrovica_governance.pdf)

<sup>54</sup> Po aty, dhe intervistat e KIPRED-it me zyrtarët e ICO-s dhe me aktivistët e shoqërisë civile në Mitrovicën e veriut, dhjetor 2009.

<sup>55</sup> Duke shikuar përtej urës së Mitrovicës – Pakoja plus e Ahtisarit, KIPRED, Prishtinë, tetor 2008.

<sup>56</sup> KIPRED, intervistë me një zyrtar të lartë të ICO-s, Prishtinë, dhjetor 2009.

## V. Rekomandimet

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes së tanishme dhe me synim të përmirësimit të zbatimit të planit të decentralizimit në mënyrën që do të siguronte integritetin territorial të Kosovës, do të fuqizonte shtetësinë e saj, si dhe do të konsolidonte shoqërinë e saj shumëetnike, KIPRED-i propozon rekomandimet vijuese:

- Bashkësia ndërkombëtare, posaçërisht BE-ja, duhet të kushtëzojnë çfarëdo integrimi në të ardhmen të Serbisë në BE me shpërbërjen e menjëhershme të strukturave paralele të sigurisë në Kosovë;
- EULEX-i, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë duhet të hartojnë një plan të përbashkët të veprimit për krijimin sundimit të ligjit në veriun e Kosovës;
- Qeveria e Kosovës duhet të hartojë strategjinë konkrete lidhur me integrimin e veriut të Kosovës, e cila do të kombinonte masat politike, ekonomike dhe ato të ndërtimit të besimit; \*
- Qeveria e Kosovës duhet të ndalojë financimin e Administratës së UNMIK-ut në Mitrovicë (AUM) dhe të vazhdojë me themelimin e EPK-së për Mitrovicën e Veriut;
- Qeveria e Kosovës, bashkësia ndërkombëtare dhe komuniteti i donatorëve duhet t'i përkrahin projektet zhvillimore, që vijnë nga komunat e reja me shumicë serbe;
- MAPL-ja dhe Qeveria e Kosovës duhet të zotojnë mjete financiare për ndërtimin e objekteve komunale në komunat e reja sa më shpejtë që të jetë e mundur;
- Qeveritë komunale në Novobërdë dhe Shtërpce duhet të formohen përmes koalicioneve qeverisëse shumëetnike mes partive politike shqiptare dhe serbe;
- Qeveria e Kosovës duhet të emërojë “këshillat e përkohshëm për qeverisje komunale” për Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok. Po ashtu, ajo duhet të sigurohet për krijimin e plotë të sundimit të ligjit para mbajtjes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme komunale.

---

\* Shih shtojcën I për propozimin e hollësishëm lidhur me pakon ekonomike.